



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:079931
Datë: 22.04.2024
Numri i dokumentit: 05600394

A.nr. 958/22

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni, në konfliktin administrativ sipas padis të paditëses, S.C. nga ..., në adresën ..., kundër të paditurit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me seli në Sheshin “Nënë Terezë” Prishtinë, për shkak të “anulimit të vendimit”, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur në prani të palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur dhe palës së interesit, me datë 28.03.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditëses, ... nga komuna e dhe anulohet vendimi me numër A.62/2022, i datës 10.03.2022, i të paditurës Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës (KPMSHCK), dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

A r s y e t i m

Paditësja me datën 21.04.2022 ka parashtruar padi, dhe gjykata për të shqyrtuar të njëjtën ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, e cila është mbajtur me datë 28.03.2024, konform nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në prezencën të palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur dhe palës së interesit ...- të ftuar në mënyrë të rregullt gjyqësore (fletë-kthesat te datës 11.03.2024 dhe 15.03.2024).

Paditësja me datë 21.04.2022, ka paraqitur padi në këtë Gjykatë me të cilën ka kërkuar të aprovohet në tërësi kërkesëpadia dhe të anulohet vendimi me A.62/2022, i datës 10.03.2022, dhe të mbetet ne fuqi vendimi i Këshillit Prokurorial të Kosovës me numër KA.nr.01/2022,

Ndërsa në shqyrtimin gjyqësor paditësja pranë kësaj gjykate ka theksuar se, kërkon nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia e saj si e bazuar dhe të anulohet vendimi konstatues i të paditurës i datës 10.03.2022 me nr.62/22, si i pabazuar në ligj dhe të mbetet në fuqi vendimi i KPK-së me të cilin është shpallur kandidate e suksesshme dhe po ashtu të kthen në vendin e punës zyrtar administrativ në Njësinë për Shqyrtimin e Performancës të Prokurorisë. Gjithashtu e njoftoi gjykatën që këtu pala e interesit me të cilin është aprovuar ankesa pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës konsideroi se është bërë në mënyrë të padrejtë pasi që i njëjtit tek organi i shkallës së parë nuk i ka bashkëngjitur të gjitha dëshmitë, e as te organi i shkallës së dytë nuk i ka plotësuar kushtet ligjore që të hyjë në listën e ngushtë. Gjithashtu, e njoftoj gjykatën që trusi nuk është provë e mjaftueshme për përvojën e punës pasi që i njëjti pranë organit të punësimit nuk i ka paraqitur edhe dëshmitë tjera që ka përvojë pune në institucione të ndryshme.

E paditura në përgjigjen në padi të parashtruar në gjykatë me datën 09.01.2024, kërkon nga gjykata të refuzohet padia e paditëses si e pa bazuar me ligj dhe të mbetet në fuqi vendimi i e paditurës me numër A.nr.62/2022 i datës 15.03.2022 me numër t protokollit 1392/2022 si i bazuar në ligje. Andaj konsideron se vendimi i KPMSHCK-së është vendim i drejtë i bazuar në dispozita ligjore ndërsa padia e paditëses është e pabazuar dhe gjykatës i propozon të merr aktgjykim me të cilin e refuzon padinë e paditësit si të pabazuar dhe vërteton vendimin e KPMSHCK si të bazuar në ligj.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të datë 28.03.2024, ka bërë administrimin e provave dhe atë: vendimi dt.10.03.22 me nr.62/22, konkursi i dt.26.03.21 me nr.193/21, njoftimi për përzgjedhjen përfundimtare dt.26.01.22, aktgjykimi dt. 09.07.20 me nr.1583/20, aplikacioni për punësim për ... dt.29.12.22, pasqyra e llogarisë për22.01.2014-22.09.21, vërtetimi dt.29/01.18, diploma për ... dt.24 11.16, diploma për ... 07.09. 2017, vendimi dt.19.01.22 me nr.01/22, vendimi dt.20.05.19 me nr.934/19, ankesa dt.24.01.22, vendimi dt.19.01.22, emali dt.24.01.22, njoftimi për kandidat të përzgjedhur dt.13.01.22, ankesa e dt.14.01.22, certifikata për Valmir Hoxha 29.09.20, certifikata e vitit 2018 Nëntor 2017, vërtetimi 29.01.19, certifikata e vitit 2019 dhe 2020, 2017, kopja e letërnjoftimit dt.03.03.2014, formulari për regjistrimin e anekses dt.25.01.22, shkresa e dt.10.02.22, regjistri i aplikacioneve të pranuar dt.10.01.21, aplikacioni për punësim për ... dt.05.01.22, certifikata për ... 02.06.21, kontrata për themelimin e punës dt.14.12.20 për ..., aneksi i kontratës i dt.14.04.21, vërtetimi për ... dt.07.08.18, referenca për ... dt.04.02.19, certifikata dt.16.12.2019, dëshmi për dorëzim të aplikacionit 29.12.21, fletë kthesat dt.22.03.22, dt.22.03.22, njoftimi dt.04.04.22, kopja e diplomës për ... dt.07.06.21.

Gjykata vlerësoj ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.

Gjykata gjen se, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Këshillin Prokuorial të Kosovës me vendimin e datës 19.01.2022, me numër KA.nr.01/2022, e ka refuzuar ankesën e ushtruar nga ankuesi ..., kandidat në procedurë e rekrutimit për pozitën Zyrtar Administrativ, në Njësinë për Shqyrtimin e Performances së Prokurorisë e dorëzuar me datën 14.01.2022, e protokolluar me numër 68/22022 me arsyetim se, “në konkursin e shpallur përveç diplomës universitare është kërkuar edhe një vit provoj pune, për plotësimin e këtij kriteri ankuesi e ka paraqit diplomën universitare ndërsa sa i përket dëshmisë mbi provojnë e punës ankuesi nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme as me dorëzimin e aplikacionit por as në aneksen e datës 14.01.2022, pran këtij komisioni.

E pakënaqur me vendimin e lartcekur ankuesi këtu pala e interesit ... ka paraqitur ankesën me nr.62/2022 të datës 25.01.2022 pranë të paditurës, Këshillit i Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.

E paditura, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës e ka aprovuar si të bazuar ankesën me nr.62/2022 te datës 25.02.2022 dhe ka shfuqizuar Vendimin me nr.K.A.nr.01/2022 të datës 19.01.2022, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave te Këshillin Prokuorial të Kosovës dhe vendos të anulohet procedura e rekrutimit për pozitën e punës “ zyrtar Administrativ në Njësinë për shqyrtimin e performances me numër te referencës KPK/SKPS/NJSHPP-POZ-24 si dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga kjo procedure, dhe ka obliguar Sekretarin e Përgjithshëm të KPK-së që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi te këtij vendimi.

E pakënaqur, me vendimin e te paditurës, me numër 62/2022 te datës 01.03.2022, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, paditësja ..., ka ushtruar padi në këtë gjykatë me date 21.04.2022, duke kontestuar ligjshmërinë e tij.

Gjykata duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi iu referua nenit 18 paragrafi 1 të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës, nr. 03/L-149, i cili përcakton se, “Pranimi në shërbimin civil mbështet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë se komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t’u atakuar në fund të procedurës”. Ndërsa neni 11 paragrafi 1 i te njetit ligj përcakton se, Parimi i shërbimit civil te Kosovës bëhet në pajtim me parimin e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërinë, mundësive te verifikimit të zotësisë se kandidateve.

Gjithashtu, gjykata ju është referuar edhe dispozitave të Rregullores nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, nenit 28 paragrafi 1 i cili përcakton se, anëtarët e KPMSHC vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve ne vijim; 1.1 Arsimimi dhe kualifikimi profesional ; 1.2 provoja e punës, 2. Secili anëtar vlerëson kandidatin ne te cilin kriter. Numri maksimal i se cilit është 20 pikë. Numri maksimal është 80, ndërsa minimumi për vazhdimin e kandidatit ne procedura të tjera është

4 pike. 3 Kandidatet të cilët nuk arrijnë numri minimal të pikëve përjashtohet nga fazat të tjera përzgjedhjes.

Gjykata gjen se, se në konkursin e shpallur të datës 22.12.2021, për pozitën Zyrtar Administrativ në Njësinë për Shyrtimin e Performances së Prokurorisë në KPK shihet se, kriteret e konkursit ka qenë Diploma Universitare, Fakulteti juridik, Fakulteti Ekonomik ose Shkencor Shoqërorë dhe një vit provojë pune. Gjithashtu, në konkurs është cekur se “Aplikacionet e dërguar me post, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të meren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 viteve, aplikacione që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuar nuk do të shqyrtohen fare”.

Duke u bazuar në dispozitat e lartcekura gjykata gjeti se paditura nuk e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe materjale në mënyrë të drejt, por vetëm ka dhënë një sqarim i cili nuk përputhet me gjendjen faktike dhe provat nga shkresat e lëndës- duke e dhënë një arsytimin mangët se “*procedura e rekrutimit për pozitën “zyrtare Administrativ në njësinë për shqyrtimin e performances së Prokurorisë në Këshillin Prokuroria të Kosovës nuk është zhvilluar konform dispozitave të Rregullores nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Ligjit për Shërbyesit Civil, dhe mbi këtë bazë ka aprovuar ankesën këtu të palës se interesit ...”*. Andaj, gjykata në rastin konkret kërkon të sqarohet nga e paditura, se në rastin e aplikimit (për pozitën e lartcekur) pala e interesit ..., a i ka bashkëngjitur të gjitha dokumentet e kërkuar siç është kërkuar konkursin e lartcekur – Aplikacionin së bashku me provat-dokumentet dhe të sqarohet çështja se pran “Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Këshillin Prokurorial të Kosovës a janë prezantuar dokumentet respektivisht provoja e punës, pasi që me vendimin e datës 19.01.2022, me numër KA.nr.01/2022, të Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Këshillin Prokurorial të Kosovës, është *cituar sa i përket dëshmisë mbi provojnë e punës ankuesi nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme as me dorëzimin e aplikacionit por as në ankesën e datës 14.01.2022”*.

Sipas dispozitave të nenit 48, të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, paragrafi 1 përcakton: “Arsyetime i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetime përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim”, ndërsa paragrafi 2 thekson, se: “2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij, ndërsa në arsyetimin e të paditurës, shihet qartë se nuk janë respektuar këto dispozita.

Gjykata si rregull konfliktin administrativ e vendos në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga vendimi i goditur me padi nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike.

Në këtë mënyrë, vendimi konsiderohet se përmban të meta për shkak të të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave ligjore, të cilat pamundësojnë shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit ose edhe vendosjen në mënyrë meritore nga ana e gjykatës, andaj, gjykata konform nenit 43.2 të LKA-së, vendosi që çështjen ta kthejë në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura si dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në këtë drejtim, gjykata e obligon organin e paditur, në kuptim të nenit 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në ri-procedurë të veprjës sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim, dhe pasi t'i mënjanojë të metat e cekura, të merr aktvendim të drejtë, të bazuar, udhëzues për palën paditëse në mbrojtje juridike dhe palët të njoftohen me kohë.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

A.nr.958/2022, data 28.03.2024

G j y q t a r e

Luljeta Maxhuni

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa,
në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit,
në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.